LIGJ
Nr.9208, datë 18.3.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8652, DATË 31.7.2000 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE"

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në pikën 5 të nenit 31 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Në rendin e ditës përfshihen, me përparësi, propozimet për vendime të kryesive të fshatrave nën juridiksionin e komunës/bashkisë përkatëse.".

Neni 2

Në nenin 33 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:
"3. Vendimet, për rastet e parashikuara në shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f"', "g", "gj", "i" dhe " j" të nenit 32 të këtij ligji, merren me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.".
2. Në pikën 4 fjalët “shkronjat “e” dhe “f”” zëvendësohen me fjalët “shkronja “e””.

Neni 3

Në nenin 35 pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:
"2/1. Për këshillat komunalë/bashkiakë janë të detyrueshme seancat e këshillimit me kryetarët dhe kryesinë e fshatrave nën juridiksion, në përputhje me përcaktimet e bëra në shkronjat “ç”, "dh”, “e”, "f", "k" dhe "ll" të nenit 32 të ligjit. Seancat e këshillimit, në këtë rast, shënohen në procesverbal.".

Neni 4

Në nenin 45 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:
1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
"1. Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhjen e fshatit, me shumicën e votave të pjesëmarrësve, me të drejtë vote, në mbledhje. Në rastet kur fshati përbëhet nga disa lagje, secila nga ato zgjedh një anëtar kryesie. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli komunal/bashkiak përkatës.".
2. Pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:
"7. Kryesia e fshatit merr nisma për probleme të ndryshme për interesin e komunitetit, të cilat ia propozon për shqyrtim këshillit komunal/bashkiak.".

Neni 5

Në nenin 46 të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

" 2. Këshilli komunal/bashkiak, për të realizuar funksionet e veta, mund t'i ngarkojë kryetarit ose kryesisë së fshatit detyrat e mëposhtme:

a) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm;

b) marrjen e masave në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara;

c) marrjen e masave në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdo lloj dëmtimi në rrugët, trotuaret dhe sheshet publike të fshatit;

ç) marrjen e masave për ndriçimin e mjediseve publike;

d) administrimin e varrezave dhe garantimin e shërbimit të varrimit;

dh) mbarëvajtjen e shërbimit të dekorit në fshat;

e) administrimin e lulishteve dhe të zonave të gjelbëruara publike;

ë) marrjen e masave për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave;

f) kujdesjen për mbledhjen e taksave dhe të tarifave;

g) ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimin e veprimtarive dhe administrimin e institucioneve përkatëse;

gj) përmirësimin e shërbimit social dhe administrimin e institucioneve, si çerdhet etj.;

h) përmirësimin e shërbimit veterinar;

i) kujdesjen për ruajtjen e pyjeve, të kullotave dhe të burimeve natyrore;

j) përkujdesjen për institucionet e arsimit dhe të shëndetit parësor;

k) detyrat e tjera të parashikuara në rregulloret e këshillit;

1) vënien e gjobave kur vërehen shkelje në përputhje me rastet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "h", "i" të këtij neni.".

2. Në pikën 5, pas fjalës "kryetari" shtohen fjalët "dhe kryesia e fshatit".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4183, datë 25.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu